

**“SHPËTIMTARËT E ARSIMIT “**

Ish zyrtarët arsimor, lokal dhe qendror, qeveritarë dhe joqeveritarë e dinë mirë, që Reforma në Arsim, në Kosovë, nuk fillon në vitin 2021, por dy dekada më parë! Projekti 6 vjeçar nga Kanadaja, KEDP (Kosovo Educator Development Project); (2001-2007) mundësoi trajnimin e më shumë se 14 mijë mësuesve, në tërë Kosovën, në zbatim të përvojave dhe teknikave bashkëkohëse në mësimdhënie.

Pas Luftës (1999), shkolla jonë ishte e shkatërruar në çdo pikëpamje. Ajo do të mbetej dhe shumë kohë jashtë rrjedhave, sikur të mos na ofrohej mbështetje financiare dhe logjistike nga shumë agjensione, shoqata dhe asociacione ndërkombëtare si KEDP, SAVE THE CHILDREN, ANDRA, CIDA, të cilave populli i Kosovës iu shprehë përjetësisht falënderim dhe mirënjohje, duke iu mbetur borxhli përgjithnjë! U derdhën shumë para për trajnimin dhe kualifikimin e mësuesve, para dhe përgjatë shërbimit; nëpërmjet seminareve dhe konferencave u trajnuan shumë kadro universitare, u përkthye literaturë e mjaftueshme e procesit të mësimdhënies, por u botua dhe literaturë origjinale metodologjike në gjuhën shqipe. Në fund të “ditës”, pas dy dekadave, sipas PISA/2015 dhe PISA/2017 Arsimit kosovar barasvlerësohet me Arsimin afrikan! Jemi bërë “natë në fytyrë” duke u futur në “gojën e botës”! Ekziston bindje reale që shkolla shqipe e “burgosur” (1990- 2000) ishte më cilësore se kjo e ditëve tona!!

“Rezultatet në PISA dëshmojnë që dijet e nxënësve nuk janë funksionale për jetën reale. Ata nuk mund të kuptojnë, përpunojnë, përdorin, vlerësojnë, reflektojnë dhe integrojnë informacionin. Nuk janë në gjendje ta përfaqësojnë matematikisht një situatë të thjeshtë, nga jeta e përditshme, ta identifikojnë e të shpjegojnë saktë një dukuri shkencore”.

**Kosova është përjashtuar nga Asociacioni Europian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA)** (3 tetor 2019), si rezultat i ndërhyrjeve politike në Agjencinë e Akreditimit dhe vendimeve arbitrarë të politikës! (Kjo i bie sikur Kosova të përjashtohet nga UEFA në futboll)!

“Rindërtimi i mendjes së shkatërruar të një populli, nga “Industria e keqe e Arsimit”, merr kohën e dekadave të tëra. Dhe në ndërkohë bota ecën më tutje, neve na përsëritet historia e të qenurit të vonuar”.

Për të qenë Reforma shkollore e suksesshme nevojitet **“fara e shëndoshë”**, **“vullneti i mirë”** dhe **“trualli i përshtatshëm”**. Dy të parave nuk mund t’iu bëhet vërejtje. E treta për ne shqiptarët, në “dy anët e kufirit” edhe shumë kohë do ndodhet në tranzicion. Mbetet për t’u dëshiruar, që të mendohet e veprohet njësoj në Kosovë dhe Kanada; Shqipëri dhe Itali.

Aktualisht, **Arsimi në Kosovë është i politizuar**, në të gjitha shkallët e shkollimit, herë-herë edhe skajshmërisht! Menjëherë pas Luftës (1999), në Rektorat ndodhi “kthesa”. “Dhanë dorëheqje” personeli udhëheqës i cili pati guximin të dalë para tankeve, në mbrojtje të shkollimit shqip të “burgosur”! Partitë politike të të gjitha krahëve synuan kontrollin mbi Universitetin; ata kishin “etje të madhe të ndajnë diploma”, të zgjedhin e të zgjidhen dekanë, senatorë dhe rektorë sipas përkatësisë partiake! Nga të shkruarit e shkencës në libra u kalua në “pajisjen me doktoratura”, sepse përndryshe rrezikohej vendi i punës! Shumë Tema u punuan nga “bedelët”. Plagjiatorët, jo që nuk janë ndëshkuar dhe mbetur pa tituj, por zakonisht kanë avancuar! Rezultatet e një politike të tillë 20-të vjeçare në arsimin kosovar janë të prekshme! “Vendi ynë është i pari në Evropë për nga analfabetët funksionalë, produkt i një sistemi tmerrësisht të dobët arsimor”. Dhe ta dini, po nga UP-ja filloi tatëpjeta e madhe e Sistemit Arsimor, e cila nuk ka të ndalur, e ndihmuar dhe nga Universitetet Private (Politike)! Sikur lexuesi t’i dijë të gjitha këto që u theksuan më lartë, atëherë lidhur me shkrimin vijues, do çuditej më pak!

“Në Greqinë e lashtë, njerëzve për një libër të shkruar u kushtoheshin rite, ku flijoheshin edhe qetë. Sot pas 30-të shekujve, në mjediset e prapambetura, veçmas në qendër të Ballkanit këta intelektualë “lëçitën” dhe “linçohen”; veprat e tyre “mohohen” dhe “ndalohen”, për të mos penguar vazhdimin e prapambeturisë”!

Populli shqiptar e përdorë thënieën: “Ra ky “mort” dhe u pamë”! U ribotua një libër **“Metodologji e Mësimdhënies së Matematikës”** ( i plotësuar dhe i përmirësuar), i vetmi i këtij lloji në trevat shqiptare, në vitin e “lulëzimit” të Pandemisë COVID-19, kur vdekjet e personave të moshës 75-të vjeçare, si kjo e libërshkruesit, ishin të “porositura”!

Libri i shtatë **MMM** (2020) doli nga shtypi më 1 Shtator 2020, atëherë kur viti shkollor 2020/21 po fillonte relativisht mbarë, pa kufizime të mëdha! Por “njerëzit e politikës” të veshur me pushtetin lokal,

të sistemuar në vende “qeveritare” dhe “joqeveritare” ishin futur në “istikame”, duke propaganduar në drejtoritë e shkollave dhe jo vetëm, që libërshkruesi i kësaj mësimdhënieje “nuk bën të komunikojë me mësues”, lidhur me promovimin dhe plasimin e librit tek lexuesi!

Libërshkruesi kishte vizituar një “*Asociacion joqeveritar*”; *Drejtorinë komunale të Arsimit* duke iu dhurua kopje libri, (të dyja në lidhje vertikale me Pushtetin vendor); një *shkollë të mesme* ku “*mungon Orientimi profesional*” dhe një **shkollë fillore**, e cila në vitet e 70<sup>ta</sup>, të shek. të kaluar, ishte “model e javës pesëditore të punës” në Kosovë! Për ta promovuar librin nëpër shkolla, me pengesa të kësaj natyre, autori nuk ishte ndeshur, as në kohën kur shkolla shqipe ishte e “burgosur”!!!

Paksa më vonë u “zbulua arsyeja”, përse u krijua situatë e “ndalimit” të librit, edhe pse në libraritë e kryeqytetit shitej nga fillimi, pa pengesa! Në cilësinë e “*shpëtimtarëve të arsimit*” synohej të vazhdohet situatë “status quo” në Arsim, meqë Pushtetet Qendrore përgjatë dy dekadave nuk ia dolën ta rikthejnë shkollimin cilësor (të viteve 80<sup>ta</sup> i cili na iku), por e ranguan me Arsimin afrikan!

“*Shpëtimtarët e Arsimit*” vlerësonin që libërshkruesi nuk ishte kompetent të merret me Objektiva të caktuar të Reformës shkollore, me pretendimin që autori i “*shtatë librave universitare*” është “cullak”!

*Sipas “shpëtimtarëve” të Arsimit, libri përmban Tema Tabu*, të cilat askush, asnjëherë “nuk ka guxuar t’i përmend”! Me gjasë, për këtë u thirrën “ndaras” për të dhënë gjykimin dhe vlerësimin, njëri ndër mësimdhënësit më të njohur të kësaj fushe që ka Shqipëria dhe Ministri aktual (2021) i Arsimit të Kosovës, të cilët i dolën krah autorit, librit dhe Reformave të mirëfillta, duke i bërë me dije të pranishmit që Reforma shkollore zgjatë (20-25) vite. Shqipëria dhe Kosova janë vende të vogla, demokracia e të cilave është e brishtë; *me ndërrimin e Qeverive, nuk bën të kemi politizim dhe ndërhyrje në Arsim!*

Në trevat shqiptare, për fajin e mësuesve tanë matematikanë, nuk kishte kuadro të mirëfillta nga MMM. Në studimin tim, me fakte dhe analiza, kam mbrojtur tezën që *MMM është disiplinë matematike* por jo pedagogjike! Le të heqim këto paralele:

Disiplinat shkencore Teknike kërkojnë dhe marrin ndihmë nga Matematika dhe ajo shërben si udhërrëfyese duke ushtruar edhe kontroll në disiplinat Teknike; si i shfrytëzojnë ato ligjshmëritë matematike. Megjithatë, **asnjë disiplinë shkencore Teknike**, edhe pse të gërshetuara dhe të udhëhequra me njohuri të thella të arsimit matematik, **nuk konsiderohet disiplinë matematike**.

Po ashtu do të thoshim: MMM kërkon dhe merr ndihmë nga **Didaktika** dhe ajo shërben si udhërrëfyese duke ushtruar edhe kontroll në MMM, si i shfrytëzon ajo ligjësitë e procesit të mësimdhënies. Kështu MMM edhe pse gërshetohet dhe udhëhiqet me njohuri të ngjeshura Didaktike, **nuk duhet konsideruar disiplinë pedagogjike!**

Çfarë përmbanin “**Temat Tabu**” të cilat “**do ta prishnin Arsimin**”, për të cilat kanë kundërshtuar hapur SBASHK-u, drejtorët por dhe shumë ish qeveritarë të lëmit të Arsimit?! Ta zëmë:

1. Përdorimi i librave shkollor alternativ dhe në gjuhë botërore (anglisht ose gjermanisht);
2. Konsolidimi i Pushtetit të notës, nëpërmjet tre vetave;
3. Eliminimi i *dysht famëkeq* (nuk di si duhet, por bën përpjekje!); i aplikuar që nga viti 1963!
4. Testimi i nxënësve, pa e treguar identitetin (emrin dhe mbiemrin se cili është?!);
5. Shuarja e Qendrave Didaktike;
6. Themelimi i Inspektoratit arsimor, lokal dhe qendror, lidhur me mësimdhënie, me kompetenca këshilluese-ekzekutive e të ngjashme, me llogaridhënie;
7. Organizimi i Mësimin Plotësues, obligativ;
8. Organizimi i Mësimin Ekipor, në mbështetje të kapaciteteve kadrovike;
9. Arsimit kompjuterik obligativ;
10. Aplikimi i mësimdhënies dhe i mësimnxënies në distancë;
11. Aplikimi i vlerësimit në Dosje;
12. Zhvillimi i mësimdhënies sipas strukturës E R R; me Teknika e Strategji të Zhvillimit të Mendimit Kritik (34);
13. Zbritja e mësimdhënies tek nxënësi. Nxënësit një nga një, ta pranojnë rolin e mësuesit;
14. Aplikimi i Objektive të shkollës së shekullit 21<sup>-të</sup>;
15. Objektivat mësimorë në mësimdhënie; *Në fund të orës mësimore, nxënësi të jetë i aftë:*

Të dallojë...Të identifikojë...Të klasifikojë...Të vizatojë...Të formulojë...Të gjykojë...Të veçojë...  
Të zgjidhë...Të “zbulojë”...Të tregojë...Të provojë...Të demonstrojë...Të copëtojë... Të përcaktojë...  
Të llogaritë...Të ilustrujë...Të mbrojë...Të argumentojë ...etj.

16. Sa dhe si plotësohen Objektivat mësimorë për klasat: E pesta Fillore dhe E nënta e Shkollës së Mesme të Ulët ? Këta objektiva a janë të prekshëm?

17. Çfarë objektiva mësimorë përmban Shkolla e Mesme e Gjinnazit?

18. Gjinnazi është shkollë e mesme “pa zanat”! Si orientohen, ndihmohen, kontrollohen dhe udhëzohen nxënësit për ta zgjedhur tamam profesionin e jetës?!

19. Dështimet në shkollën e Gjinnazit! Çfarë flet praktika jetësore? Çfarë mund të përmirësohet?

20. Çfarë duhet të jetë udhëheqja kadrovike e gjinnazeve?

21. A fillon nga këtu “*Arsimi i politizuar*”, kur në “fund të ditës” *juristi emërohet Ministër i shëndetësisë* ndërsa *ekonomisti emërohet Ministër i Arsimit* e postet i pranojnë me qejfe!

Le të marrim për shqyrtim vetëm **Temën** e parë **Tabu** lidhur me *librat shkollorë*. Vërejtjet e thëna lidhur me librat kishin hatërbetje, ku pezmi shprehej “*në libër nuk bën të kritikohet libri*”! Por MMM është “dora e fundit” nëpërmjet së cilës analizohet cilësia e librit! Librat tanë shkollorë përmbajnë gabime të natyrave të ndryshme, të përsëritura, nga viti shkollor në tjetrin:

a) Ekzistenca e paradoksit, numri i faqeve të librit (kl. V-VIII) nga viti në vitin tjetër shkollor zvogëlohet: (f.242; f.183; f.157). Nuk ka bashkërendim kurrikular, mes autorëve të librave;

b) Ekzistenca e paradoksit, numër më i madh i rregullave dhe përkufizimeve mësohen në klasat e VI-ta, në krahasim me klasat VII-ta dhe klasat e VIII-ta (125; 64; 68);

c) Paraqitje e përsëritur e përkufizimeve, në klasa të ndryshme;

d) Komponimi i rregullave dhe përkufizimeve me shumë fjalë, por edhe duke i përsëritur fjalët;

e) Në vitin 2007 ndodhi që për klasën V fillore, të kemi në qarkullim 4 libra, të cilat së bashku numëronin 352 faqe dhe kushtonin 7,5 Euro !

I. Në librat ekzistuese të Shkollës së Mesme të Ulët (VI-IX) nga nxënësit kërkohet që mësimi t’i qasën nëpërmjet shkathtësive intelektuale të ulëta, siç janë *mbajtje mend* dhe *riprodhim i informacioneve* të mbajtura mend.

II. Nuk vërehen askund gjurmë për të pasur *Mendim Kritik* ndaj informacioneve;

III. Po këtu mungon *të mësuarit me objektiva*;

IV. Nuk vërehen as gjurmë të *zhvillimit të mësimi sipas strukturës ERR* ; as gjurmë të *teknikave dhe strategjive bashkëkohëse në mësimdhënie*. Nëpërmjet këtyre të fundit ndryshohet fokusi i të nxëniti (ndërtimi i kuptimit të tekstit dhe jo përsëritje e fjalëve të tekstit);

V. *Përmbajtjet* e librave janë të sofistikuar, me peshë të rëndë për bartje, familjari bëhet “hamall”

VI. Edhe pas 20-të viteve, mësuesit që aplikojnë mësimdhënien bashkëkohëse, aktualisht janë “specie” të rralla. Përgjatë këtyre viteve nuk u botua asnjë libër matematike i cili kishte për të ofruar shkëputje fillestare nga mësimdhënia tradicionale. ***Librat shkollor bien ndesh me aktualitetin arsimor (por dhe me këtë Metodologji).***

#### NË VEND TË PËRFUNDIMIT

Faktet e përmendura janë reale dhe të prekshme! Vendi ynë mbetet “vend i papërshtatshëm” dhe për Arsim! Pas një pune sistematike 40<sup>-të</sup> vjeçare u botua një libër **Metodologjie**, lidhur me mësimdhënien bashkëkohëse të matematikës, të cilën njohësit e fushës e pagëzuan **Abetare e matematikës!** Edhe pse aty nuk vërehet asnjë shenjë ideologjie, Politika lokale së bashku me njerëzit e saj, *u ulën këmbëkryq në atë libër*, duke ia ç’pikur “*bishtin*” **Tema Tabu!**

Për motive të ulëta apo dhe të larta, përgjatë një viti shkollor (2020/21) penguan deri në zhatje promovimin deri në plasim të librit MMM/2020, nëpër shkollat e vendlindjes, edhe pse libërshkruesi nuk i përkiste asnjë partie politike! Nëpërmjet Mendimit Kritik, “asgjë nuk ka mbetur pa u lexuar”! Intelektuali po qe se nuk orientohet dhe udhëhiqet me qëllimin e mirë, jo vetëm që nuk sjellë dobi, por ai shkakton dhe shumë dëme! Sikur këta persona të ishin veshur me Pushtet Qendror, me gjasë do ta tërhiqnin librin nga shitja, për të cilin kemi pritur 70<sup>-të</sup> vite që ta shkruaj një matematikan shqiptar!

19. 09. 2021, Gjakovë